

VENDIM
Nr. 864, datë 30.12.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar; të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “c”, të pikës 1, të kreut I, shtohet emërtesa “Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes”;

b) Pas pikës 8/6, të kreut III, shtohet pika 8/7, me këtë përmbajtje:

“8/7. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes janë sipas lidhjes nr. 9/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”;

c) Katër rreshtat e fundit të lidhjes nr. 9/3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

C3	<u>Në DPD:</u> Sekretar/protokoll; Arkivist; Përpunues informacioni; Doganier pike kontrolli. <u>Në degët doganore:</u> Doganier peshoreje/pike kontrolli; Sekretar; Arkivist.			47 000	9 000
D1	<u>Në DPD:</u> Magaznier; Teknik marinë/motorist; Teknik mirëmbajtjeje; Shofer. <u>Në degët doganore:</u> Magaznier.			45 600	4 000
D2	Punëtor mirëmbajtjeje në degë doganore			Klasa IV sipas VKM-së për pagat e punonjësve mbështetës	4 000
D3	Sanitar/punonjës pastrimi në DPD dhe degë doganore			Klasa I sipas VKM-së për pagat e punonjësve mbështetës	4 000

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Lidhja nr. 9/7

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lekë/muaj)
Titullar i institucionit	I-3	1	120 000
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes Koordinator në varësi të drejtpërdrejtë të titullarit	II-1	1	110 000
Ekspert në njësitë organizative të përmbajtjes Inspektor	II-2	1	90 000
Drejtor i drejtorive mbështetëse	II-2	1	0
Përgjegjës i sektorëve mbështetës	III-2	1	0
Specialist në sektorët dhe drejtoritë mbështetëse	IV-2	1 ose 2 ose 3	0